



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 254, Datë 23.08.2023

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “G.S.K” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË
INSTALUAR 2 MW**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38, pika 1, gërma “a” dhe 39, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.08.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1931/7 prot., datë 17.08.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë “G.S.K” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “G.S.K” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1931 prot., datë 17.07.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 237, datë 27.07.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “G.S.K” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 28.07.2023 dhe 29.07.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 06.08.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1931/3 prot., datë 31.07.2023, depozitoi dokumentacion plotësues të këtij aplikimi. ERE, me shkresën nr. 1931/4 prot., datë 08.08.2023, njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 237/2023, dhe evidentoi dokumentacionin që mbetej ende pa plotësuar. Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1931/5 prot.,

datë 14.08.2023, depozitoi dokumentacion plotësues të këtij aplikimi. ERE me shkresën nr. 1931/6 prot., datë 16.08.2023, njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “G.S.K” sh.p.k.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e licencimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “G.S.K” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, gërma “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se, nga sa deklaruar nga shoqëria, rezulton se jetëgjatësia e pritshme e centralit është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë, deri në 25 vjet.
- Për sa parashikuar në VNM-në Paraprake në lidhje me zbatimin në terren të projektit, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë të informojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, deri më datë 23.06.2024 (datë në të cilën përfundon dhe vlefshmëria e kësaj VNM-je).

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “G.S.K” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 25-vjeçar.
2. Shoqëria të informojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, deri më datë 23.06.2024.
3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të informacionit sipas përcaktimeve të pikës 2, në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së Paraprake.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “G.S.K” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI